



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ELIDA TAKE
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR. 5, RR. TISH DAIJA, GODINA NR.
9, NJESIA 1, HYRJA 1
TEL: 0698885621

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 652

Nr. koleksioni: 434

Tirane më 23/06/2025

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2025053770046456191



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

STUDIO NOTERIALE ELIDA H. TAKE

Adresa: rr" Tish Daija" Kompleksi "Kika 2", Godina 9, njesia 1-Tirane

e-mail : elidatake@yahoo.it. Mobil.0698885621

Nr. 652 .rep.nr. 434 .kol.

Taksa e pulles u pagua

KONTRATË SHITBLERJE KUOTASH KAPITALI

Sot më datë 23.06.2025 (dymijë e njëzet e pese), para meje noterit publik, Elida H.TAKE, anëtar i Dhomës së Noterëve Tiranë, në zyrën time noteriale të ndodhur në rr" Tish Daija" Kompleksi "Kika 2", Godina 9, njesia 1-Tirane, u paraqitën personalisht palët kontraktuese të cilët më kërkuan hartimin e kësaj kontrate në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar) dhe statutit të shoqërisë "LAYO" SHPK, me kushtet e mëposhtme:

PALËT

Pala Shitëse:

Shoqëria "LAYO" shpk, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) me datë 17.11.2009, me NUIS - K92317014S, me qendër në Tiranë, në adresën Rruga Don Bosko, (referuar ekstrakt të QKB) – përfaqësuar nga ortakut i vetëm **z. Vasil LLAJO**, shtetas shqiptar, atesia Spiro, amesia Polikseni, lindur me 24.11.1956, ne Sarande e banues ne Tirane (sipas deklarimit të tij), madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit biometrik me nr. personal F61124009B - zotërues 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "LAYO" shpk.

Pala Blerëse:

znj.Argita BOJAXHIU, atesia Aliosha, amesia Violeta, e datëlindjes 04.05.1978, lindur në Berat dhe banues në Berat, në adresën lagjia Çlirim - Berat (sipas deklarimit të tij), madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit(ID) me numër personal H85504081J.

Kushtet Paraprake

- Pala shitëse Shoqëria Shoqëria "LAYO" shpk, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) me datë 17.11.2009, me NUIS - K92317014S, me zyrë qendrore në Tiranë me kapital të regjistruar 150.000.000,00 (njëqind e pesëdhjetë milion) lekë - përfaqësuar nga ortakut i vetëm **z. Vasil LLAJO**, është e interesuar të shesë kuotën që ai zotëron në kete shoqëri dhe pala blerëse Argita BOJAXHIU është e interesuar të blejë këtë kuotë;

Për sa më lart palët bien dakord, për sa vijon:

II. OBJEKTI



2.1 Nëpërmjet kësaj kontrate pala shitëse Shoqëria "LAYO" shpk i shet palës blerëse dhe konkterisht Argita BOJAXHIU, 1 kuotë = 100% të kapitalit që zotëron në shoqërinë "LAYO" Shpk.

2.2 Pas regjistrimit të kësaj kontrate në Qendrën Kombëtare të Biznesit, ortake e vetme e shoqërisë "LAYO" do të jetë Argita BOJAXHIU zotëruese e 1 (një) kuote e cila përfaqëson 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "LAYO" Shpk.

III. ÇMIMI

3.1 Palët bien dakord që çmimi i shitjes së kuotës, objekt i kësaj kontrate, është 150.000.000,00 (njëqind e pesëdhjetë milion) lekë. Çmimi i kontratës do të likuidohet nga pala blerëse Argita BOJAXHIU sipas shpërnadrjes së dividendëve ndër vite të Shoqërisë "LAJO" shpk direkt në llogarinë bankare të z.Vasil LLAJO.

3.2 Për çdo vonesë në pagesën e çmimit, do të aplikohet një interes në masën 10% në vit.

IV. TË DREJTA DHE DETYRIME TË PALËVE

4.1 Pala blerëse dhe/ose personat e caktuar prej saj ka/në të drejtë të ketë akses në të gjithë dokumentacionin juridik, financiar e teknik të shoqërisë "LAYO" Shpk.

4.2 Pala blerëse detyrohet të paguajë çmimin e kontratës, brenda afatit të përcaktuar në pikën 3.1 të kësaj kontrate.

V. KALIMI I PRONËSISË

5.1 Palët kanë rënë dakord që kjo kontratë shitblerje kuotash kapitali, të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), menjëherë pas nënshkrimit të saj dhe Argita BOJAXHIU do të bëhet ortakë e vetme e shoqërisë "LAYO" shpk, duke zotëruar 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

5.2 Nga momenti i regjistrimit të kësaj kontrate në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) pala shitëse, humbet çdo të drejtë pronësie mbi kuotën që ai ka në shoqërinë "LAYO" shpk. Tirane.

Kjo kontratë hartohet në 5 (pesë) origjinale në gjuhën shqipe, nga të cilat një qëndron në arkivën noteriale, një origjinal regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe më pas qëndron në zyrën qendrore të shoqërisë dhe nga një origjinal e merr secila palë.

Kjo kontratë pasi iu lexua me zë të lartë palëve nga unë noteri publik, ata më deklaruan që ajo është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë, u nënshkrua prej tyre në praninë time dhe unë noteri e vërtetoj atë në bazë të ligjit.

Ne zbatim të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", une noterja deklaroj se do të ruaj dhe perputnoj të dhënat personale të subjektit të këtij akti, në mënyrë të drejte dhe të ligjshme.

PALA SHITËSE
Shoqëria "LAYO" shpk Tirane

PALA BLERËSE
Argita BOJAXHIU

NOTER
Elida H. TAKE

Elida H. Take

ARGITA BOJAXHIU